



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 35, datë 28.03.2024

**PËR
MIRATIMIN E TABELËS SË PRIMIT TË RREZIKUT PËR PËRLLOGARITJEN E
PROVIGJONEVE TEKNIKE PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË
PËRGJEGJËSISË SË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK, PËR DËMET QË U
SHKAKTOHEN PALËVE TË TRETA NGA PËRDORIMI I KËTIJ MJETI**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe pikës 22, të nenit 14, të ligjit 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e tabelës së primit të rrezikut, për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik, për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti për kontratat e sigurimit MTPL e brendshme, tabela 1 bashkëlidhur këtij vendimi.**
- 2. Miratimin e tabelës së primit të rrezikut, për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, për kontratat Kufitare të sigurimit, tabela 2 bashkëlidhur këtij vendimi.**
- 3. Miratimin e tabelës së primit të rrezikut, për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, për kontratat Karton Jeshil të sigurimit, tabela 3 bashkëlidhur këtij vendimi.**
- 4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimet, në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**

Tabela 1: Primet e rrezikut, për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësishë së pronarit të mjetit motorik, për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, për kontratat e sigurimit **MTPL** e brendshme:

Kateg.	Klasa	Tipi	Kapaciteti motorik (cm3)/ ose pesha mbajtëse (T)/ ose numri i vendeve	Tarifat e primit të rrezikut të përlogaritura (në Lekë)
A 1		Motoçikleta	Kapaciteti motorik	
	A 1/1		Deri në 150 cm3	3,100
	A 1/2		Mbi 150 cm3	5,300
B 1		Autovetura	Kapaciteti motorik	
	B 1/1		Deri në 1600 cm3	7,900
	B 1/2		Mbi 1600 cm3	11,100
B 2		Furgonë, Mikrobusë	Numri i vendeve	
	B 2/1		Nga 5 deri në 8 vende	14,500
	B 2/2		Mbi 8 deri në 15 vende	21,400
C 1		Autobusë	Numri i vendeve	
	C 1/1		Mbi 15 vende	34,700
D 1		Kamionçina	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 1/1		Deri në 3.5 ton	14,000
D 2		Kamionë	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 2/1		Mbi 3.5 ton	25,400
E 1		Rimorkio	Pesha mbajtëse (Ton)	7,000
F		Mjete bujqësore		5,700
G		Zjarrfikëse		14,000

*Tarifat e aplikuara për shitje mund të ndryshojnë ndjeshëm nga primi i rrezikut.

Tabela 2: Primet e rrezikut, për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësishë së pronarit të mjetit motorik, për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, për kontratat **Kufitare** të sigurimit:

KATEG.	Tipi i mjetit	Tarifat e primit të rrezikut (në Euro)						
	Periudha e mbulimit:	15 ditë	20 ditë	25 ditë	30 ditë	45 ditë	6 mujore	1 vjeçare
A	Autoveturë	17	21	24	28	31	75	150
B 1	Motoçikletë	8	10	12	14	17	30	60
B 2	Motokarro	10	14	17	21	24	37.5	75
C 1	Kamion për mallra (15 deri 34.99 KV)	56	70	84	91	105	120	240
C 2	Kamion për mallra (nga 35 KV e lart)	70	84	91	105	126	200	400
D	Çiklomotor	8	10	12	14	17	30	60
E 1	Autobus	98	112	133	147	174	200	400
F 1	Rimorkio kamioni	42	49	56	63	77	90	100
F 2	Rimorkio autobusi	56	63	70	77	98	120	150
F 3	Rimorkio të tjera	21	28	35	42	49	80	100

*Tarifat e aplikuara për shitje mund të ndryshojnë ndjeshëm nga primi i rrezikut.

Tabela 3: Primet e rrezikut, për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësishë së pronarit të mjetit motorik, për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete, për kontratat e **Kartonit Jeshil** të sigurimit:

Kateg.	Tipi i mjetit	Tarifat e primit të rrezikut (në Euro)				
	Periudha e mbulimit:	15 ditë	1 muaj	3 muaj	6 muaj	1 vit
A	Autoveturë	25	40	80	140	240
B 1	Motorçikletë	10	15	25	50	95
B 2	Motokarro	25	40	60	100	170
C 1	Kamion për mallra (15 deri 34.99 KV)	55	85	170	320	520
C 2	Kamion për mallra (nga 35 KV e lart)	90	145	270	480	840
C 3	Autoambulancë, makinë funerali	60	85	210	380	600
D	Çiklomotor	5	10	20	30	60
E 1	Autobus 9+1 deri në 18+1 vende	50	70	150	300	500
E 2	Autobus 19+1 deri në 28+1 vende	90	150	270	480	850
E 3	Autobus 29+1 vende e lart	130	200	400	750	1200
F 1	Rimorkio kamioni	10	30	50	70	120
F 2	Rimorkio autobusi	20	35	55	95	140
F 3	Rimorkio të tjera	15	30	50	75	120

*Tarifat e aplikuara për shitje mund të ndryshojnë ndjeshëm nga primi i rrezikut.